

I nderuar Klient,

Të falenderojmë edhe njëherë që je pjesë e rrugëtimit të lute Albania!

Në vijim të interesimit tënd, më poshtë këtij dokumenti do të gjesh çdo informacion të nevojshëm në lidhje me Sigurimin Vullnetar të Mbrojtjes së Kredisë.

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë të mbron në rastin kur për shkak të ngjarjeve të papritura si paaftësia totale nga aksidenti, humbja e jetës apo aksidenteve dhe sëmundjeve që të bëjnë të paaftë për punë, të ardhura si pasojë për shkaqe natyrale apo aksidentale, vlera e kredisë së mbetur të mos trashëgohet tek familjarët, por të shlyhet nga sigurimi.

Pasi të njihesh plotësisht me informacionin parakontraktor, së bashku me kushtet e përgjithshme të sigurimit dhe të jesh në dakordësi me to, lutem jep pëlqimin për pranimin e tyre.

Për çdo informacion te mëtejshëm mos hezito të kontaktosh shërbimin e klientit në numrin 044505060.

Faleminderit,
Ekipi lute Albania

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë +

Dokument mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit
Shoqëria e Sigurimit: Albsig Jetë sh.a.



Paketa: Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë +

Albsig Jetë sh.a. është shoqëri sigurimi Jetë, e licencuar me Vendimin Nr. 171, datë 13.09.2019, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtarinë në të gjitha klasat e sigurimit të jetës, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky produkt ofrohet në bashkëpunim me Allianz Partners dhe GrECo Affinity Solutions.



Ky dokument jep një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm, që lidhet me këtë produkt, por nuk është i personalizuar për ty. Të gjitha detajet që lidhen me informacionin para-kontraktor dhe kontraktor për këtë produkt janë të disponueshme dhe mund të shkarkohen në faqen zyrtare të internetit <https://ute.al/sigurimi-i-mbrojtjes-se-kredisese/>, së bashku me informacionin mbi tarifat e zbatuara për këtë produkt sigurimi. Në momentin që zgjedh të sigurohesh, duke pranuar kushtet e sigurimit dhe kryer apo autorizuar pagesën e mbetur të detyrimit të sigurimit, informacioni i mësipërm do të të dërgohet së bashku me certifikatën e sigurimit edhe në rrugë elektronike.

Çfarë është ky lloj sigurimi?

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë është një produkt vullnetar sigurimi, i cili ofrohet për personat që marrin kredi dhe i mbrojnë ata nga rreziku i pamundësisë së shlyerjes së kredisë për shkak të ngjarjeve të papritura, si humbja e jetës apo aksidentet dhe sëmundjet që i bëjnë të paafët për punë. Në këtë mënyrë, vlera e kredisë së mbetur nuk trashëgohet të familjarët, por shlyhet nga sigurimi.

Në rast të ndodhjes së një prej ngjarjeve të listuara në seksionin e mbulimeve, shoqëria e sigurimit paguan pjesën e mbetur të detyrimit të kredisë, sipas kushteve të përgjithshme të kontratës së sigurimit. **Ky produkt nuk përbën detyrim për marrjen e kredisë, por është tërësisht në vullnetin e kredimarrësit.**



Çfarë mbulohet?

- ✓ Humbja e jetës si pasojë e shkaqeve natyrore;
- ✓ Humbja e jetës si pasojë e shkaqeve aksidentale;
- ✓ Paafëtesia e plotë e përhershme si pasojë e shkaqeve aksidentale;
- ✓ Paafëtesia e përkohshme për të punuar si pasojë e sëmundjeve ose shkaqeve aksidentale;
- ✓ Shërbimi "Opinionin i Dytë Mjekësor" nga qendra mjekësore të specializuara në botë;
- ✓ Zbritje në rrjetin spitalor Albsig.



Ku jam i mbuluar?

- ✓ Në gjithë botën

Në rast dëmi, kontaktimi:

- Për shërbimin e "Opinionit të Dytë Mjekësor," të lutemi të raportosh ngjarjen brenda 3 ditëve nëpërmjet linkut: <https://ute.al/ute.link/qwecDD>
- Për dëme shëndetësore ose aksidentale, të lutemi të raportosh ngjarjen brenda 3 ditëve nëpërmjet linkut: <https://ute.al/ute.link/qwecDD>
ose kontakto Albsig Jetë: **TeLl: +355 42254664 Email: contact@albsig-jete.al**



Cilat raste nuk mbulohen?

- ✗ Je në djepi të papunësisë së afërt ose pensionit që do të ndodhë gjatë periudhës së mbulimit.
- ✗ Nuk je rezident në Republikën e Shqipërisë në momentin e ndodhjes së ngjarjes.
- ✗ Ke më pak se 6 muaj i punësuar para datës së fillimit të Policës.
- ✗ Ke më pak se 12 muaj i vetepunësuar para datës së fillimit të Policës.
- ✗ Duhet të jesh rezident i përhershëm në Republikën e Shqipërisë.
- ✗ Puna aktuale është rastësore, sezonale, e përkohshme, stazh ose kontratë trajnimi.
- ✗ Kontrata jote me afat të caktuar përfundon para ose gjatë mbulimit pa rinovim.
- ✗ Ti njoftoheshpër papunësi brenda periudhës së përjashtimit fillestar.
- ✗ Pranor vullnetarisht pushimin ose dorëheqjen nga puna.
- ✗ Refuzon një ofertë për punësim alternativ të arsyeshëm.
- ✗ Papunësi nga luftë, pushtim, rebelim, revoltë ose akte terroriste të lidhura me armë bërthamore, kimike, biologjike.
- ✗ Vetëvrasja, tentativa për vetëvrasje, ose lëndimet e shkaktuara vetë.
- ✗ Ngjarje e ndodhur prej sporteve ekstreme, sëmundjeve paraekzistuese, konflikteve të mëparshme, ose pjesëmarrjes në veprimtari të paligjshme.
- ✗ Dëme të shkaktuara nën Influencën e alkoolit, drogës, ose çdo lloj intoksikanti pa recetë mjekësore.
- ✗ Vdekja e shkaktuar nga ndonjë sëmundje, infeksion bakterial ose viral, gjendje natyrore, proces degjenerativ, ose rezultat i ndonjë shkakut që vepron gradualisht.
- ✗ Je në djepi të ndonjë sëmundjeje të afërt.



A ka kufizime në mbulim?

- ! Individë më të rinj se 18 vjeç
- ! Individë mbi 64 vjeç
- ! Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm
- ! Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale

Periudha e kufizimit

- ! 30 ditët nga Data e Fillimit gjatë së cilës nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundrejt Policës, me përjashtim të Humbjes së Jetës

Periudha e pritjes

- ! Numri i ditëve pas të cilave ti mund të bësh një kërkesë dhe të marrësh çdo përfitim mujor për një ngjarje të mbuluar:

- * Aksident dhe sëmundje: pas ditës së 60-të rresht
- * Hospitalizimi: pas ditës së 7-të rresht
- ** Periudha e pritjes llogaritet duke mbajtur parasysh periudhën e kufizimit



Cilat janë detyrimet e mia?

- Të paguash primin e sigurimit, në mënyrë që mbulimi të hyjë në fuqi.
- Të lexosh me kujdes informacionin para-kontraktor dhe të japësh dakordësinë për t'u bërë pjesë e kësaj skeme sigurimi, vetëm pasi të jesh bindur që ky sigurim është i përshtatshëm për ty, por në çdo rast përpara se të vijosh me pagesën e pritit të sigurimit.
- Të na njoftosh nëse ka ndryshime në rrethanat e tua që të bëjnë të papërshtatshëm për të përfutur këtë mbulim.



Kur dhe si pagua?

- Primi mund të paguhet njëherësh ose nëpërmjet planit me këste me interes zero, të mundësuar vetëm për klientët kredimarrës të Iute.
- Primi mund të paguhet nëpërmjet të gjitha mjeteve të njohura të pagesave të ligjshme në Republikën e Shqipërisë. **IutePay nuk pranor pagesa me para në dorë.**



Kur fillon dhe kur mbaron mbulimi me sigurim?

- **Mbulimi fillon** në datën e shënuar në Certifikatën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit.
- **Mbulimi përfundon kur:**
 - o Ti anulon mbulimin brenda periudhës së lejuar 14-ditore;
 - o Huaja është shlyer, rinfancuar apo transferuar;
 - o Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe siguruesi i ka paguar përfituesit shumën e dëmshpërblimit;
 - o Është marrë përfitimi maksimal i lejuar sipas kësaj Police;
 - o Nuk jeton/punon më në Republikën e Shqipërisë.



Si mund ta anuloj kontratën?

- Ti ke të drejtë ta anulosh kontratën brenda 14 ditëve nga lëshimi i Certifikatës së Sigurimit, që përkon me datën e fillimit të mbulimit.
- Në do të të rimbursojmë plotësisht primin e paguar, përveç rasteve kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit.
- Për ta anuluar kontratën, duhet të bësh një njoftim me shkrim pranë IutePay. Nëse ke shlyer plotësisht kredinë, kontrata do të anulohet automatikisht.
- Përtej afatit 14-ditor, nuk ka rimbursim të pritit të sigurimit.

IutePay sh.p.k., e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik NIPT M022090020, është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në tregun e sigurimit të jetës me Nr. Licencë 1922/1, datë 24.11.2023.

Kontaktet për pyetje apo më shumë informacion:

Email: info@iute.al Nr. TeLl: 044 505 060

Adresa: Rruga "Andon Z. Çajupi", Pallati Nr.3, Hyrja Nr.2, Kati Nr.3, Tiranë

Stafi ynë teknik është i gatshëm të të përgjigjet çdo pyetjeje apo paqartësie që mund të kesh.





Shërbimi i Opinionit të Dytë Mjekësor (SMO)

Merrni akses në qendrat mjekësore lider në botë për të rishikuar diagnozën ose planin e trajtimit tuaj mjekësor.



Anëtarët e kualifikuar kanë akses në një shërbim të opinionit të dytë mjekësor pa kosto shtesë.

Kur përballeni me një diagnozë mjekësore, marrja e një opinionit të dytë mjekësor mund t'ju japë përgjigje të qarta që ju nevojiten për t'ju dhënë qetësinë mendore. Shërbimi ynë, i Opinionit të Dytë Mjekësor, në bashkëpunim me MediGuide, siguron që rasti juaj të shqyrtohet nga një ekip ekspertësh mjekësorë për t'ju ndihmuar në marrjen e vendimeve për trajtimin tuaj.

Nëpërmjet partneritetit tonë me MediGuide, ju keni akses në qendrat e ekselencës të njohura ndërkombëtare. MediGuide është lider në dhënien e

opinioneve të dyta mjekësore nga ekspertëve, duke ofruar një rishikim dhe analizë gjithëpërfshirëse e të gjithë informacionit tuaj mjekësor.

A kualifikohem për të kërkuar shërbimin e Opinionit të Dytë Mjekësor?

Partneri ynë, MediGuide, ofron shërbime mjekësore të opinionit të dytë për shumicën e diagnozave mjekësore. Nuk ka kufizime për moshën, nuk ka periudha pritjeje ose kufizime të gjendjes para-ekzistuese

Ky shërbim është krijuar për të ndihmuar me pyetje të rëndësishme si:

- Çfarë do të thotë diagnoza ime?
- A është e saktë diagnoza ime?
- A është trajtimi i propozuar i përshtatshëm?
- A ka informacion shtesë për diagnozën time?
- A ka trajtime alternative që mund të jenë më të efektive për mua?

GrECo,
matter of trust.



Shërbimi MSO është i disponueshëm për të gjithë me disa përjashtime nëse Ju:

- Nuk keni marrë një diagnozë zyrtare nga mjeku juaj trajtues. Është e nevojshme të paturit një diagnozë për ekspertët mjekësorë që shqyrtojnë rastin për të konfirmuar diagnozën dhe për të dhënë rekomandime mbi trajtimin.
- Nuk jeni ndjekur nga mjeku juaj trajtues në 12 muajt e fundit.
- Kërkon kujdes të menjëhershëm mjekësor për një gjendje akute ose të rrezikshme për jetën.
- Kërkohet një kontroll fizik, pasi në disa raste nevojitet një vlerësim nga afër. Diagnoza e sjelljes ose e shëndetit mendor.



Si funksionon?

Ky shërbim është në dispozicionin tuaj pa kosto shtesë. Pasi të kërkonit një Opinion të Dytë Mjekësor, të dhënat tuaja të kontaktit do t'i kalohen MediGuide International.

- **Marrja dhe telefonata hyrëse:** brënda 24-48 orëve pasi keni bërë njoftimin ne linkun [https://www.lsys-
cee.com/GrECoAffinityCenter/Online/ute](https://www.lsys-cee.com/GrECoAffinityCenter/Online/ute) do t'ju kontaktojnë nga MediGuide për të filluar trajtimin e rastit tuaj të Opinioni të Dytë Mjekësor.
- **Kaktimi i Menaxherit të Rastit dhe Mbledhja e Informacionit:** Do t'ju caktohet një person kontakti nga MediGuide, i cili do t'ju ndihmojë në mbledhjen e informacionit mjekësor dhe do t'ju udhëheqë gjatë gjithë rastit tuaj.
- **Rishikimi i rastit:** Ekipi klinik i MediGuide do të shqyrtojë rastin tuaj dhe do t'ju rekomandojë tre

qendra mjekësore lider në botë, të specializuara në diagnozën tuaj, nga të cilat mund të zgjidhni.

- **Dorëzimi i raportit dhe ndjekja:** Prisni të merrni raportin tuaj të Opinioni të Dytë Mjekësor pasi të ketë përfunduar rishikimi mjekësor. Raporti mund të përfshijë rekomandime trajtimi, detaje mbi trajtimet alternative dhe përgjigje për pyetjet tuaja.

A do të ndahet rasti im SMO me dikë tjetër?

Jo. Çdo informacion që merrni është konfidencial midis jush dhe MediGuide International, ofruesit të shërbimit. Raporti juaj i dytë i opinionit nuk ndahet me asnjë palë tjetër.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E JETËS NË GRUP PËR HUAMARRËSIT E "IUTECREDIT ALBANIA" (SIGURIMI I MBROJTJES SË KREDISË)

1. PERCAKTIME

1.1 Kushtet e Sigurimit kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësit. 1.2 Siguruesi: shoqëria e Sigurimit të Jetës "ALBSIG Jetë" – Sh.a. 1.3 Debitori individ, personi fizik ose personi juridik që është përgjegjës për shlyerjen e huasë ndaj Kreditorit apo Përfituesit. 1.4 "I siguruari" apo "të Siguruarit" individ/klient i personit juridik që ka lëvruar huanë, që përcaktohet si i tillë në Certifikatën e Sigurimit, i cili ka blerë mbulimin me sigurim dhe është i mbuluar nga kushtet e përgjithshme të kësaj police. 1.5 "Përfituesi" apo "Kreditori" personi juridik (që këtu e mëposhtë do të referohet edhe si Policëmbajtësi) që ka lëvruar huanë sipas një marrëveshje huaje dhe që përfiton të ardhurat që ofron kjo policë. 1.6 Polica e Sigurimit dokumenti që vërteton lidhjen e Kontratës së Sigurimit në grup nga Policëmbajtësi për të ofruar mbulim për klientët, që pranojnë të sigurohen, bashkë me kushtet e përgjithshme dhe anekset përkatëse, që janë pjesë e policës në fillim ose gjatë periudhës së vlefshmërisë. Vlefshmëria e Policës në Grup do të jetë për një periudhë 12 mujore e rinovueshme sipas referencave në skedulin e policës. 1.7 Hua do të kuptojmë huanë bankare apo ndonjë hua tjetër lëshuar nga ndonjë institucion kredidhënës. 1.8 Shuma e Sigurimit shuma e principalit të huasë sic ilustron në Certifikatën e Sigurimit, në ditën që fillon mbulimi me sigurim. 1.9 Prim Sigurimi shuma e parave që i paguhet Siguruesit, për mbulimin me sigurim. 1.10 Hua e Papaguar sasia e mjeteve monetare që nevojitet në çdo kohë për të paguar huanë, duke përfshirë, çdo penalitet apo interes të akumuluar siç pasqyrohet në skedulin e caktuar të amortizimit kur lëvrohet huaja, si dhe çdo shpenzim tjetër që mund të ekzistojë deri në shlyerjen përfundimtare të huasë. 1.11 Ngjarje e Sigurimit humbje e jetës e personit të siguruar brenda periudhës së sigurimit, ndodhja e të cilës sjell detyrimin e Siguruesit për të paguar përfitimin sipas kushteve të sigurimit. 1.12 Aksident ngjarja e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguruarit, e identifikueshme përsa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtëpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguruarin. 1.13 Humbja e jetes Natyrore nënkupton humbjen e Jetës si pasojë e shkaqeve natyrore, duke përfshirë aksidentet. 1.14 Rreziku i Humbjes së jetës do të nënkuptojë humbjen e jetës së të siguruarit për shkaqe aksidentale ose natyrore, brenda periudhës së vlefshmërisë së policës së sigurimit. 1.15 Terrorizem Berthamor, Kimik ose Biologjik do të nënkuptohet përdorimi i çdo arme apo paisjeje bërthamore apo lëshimi, shkarkimi, shpërndarja, lirim, apo rrjedhja e cdo agjenti kimik dhe/ose biologjik të ngurte, të lëngët apo gas gjatë periudhës së vlefshmërisë së policës, nga cdo person apo grup/grupe personash, pavarësisht nëse vepron në vetëm apo për llogari të ose në bashkëpunim me cdo organizatë/a apo qeveri, l bërë për qëllime politike, fetare apo ideologjike apo për arsye dhe me qëllimin e influencimit të cdo qeverie dhe/ose për të frikësuar publikun apo ndonjë pjesë të tij. 1.16 Agjent Kimik do të thotë cdo përbërës i cili, i përhapur në mënyrën e duhur, prodhon paafësi, efekte vdekjeprurëse apo dëmtuese mbi njerëzit, kafshët, bimët apo materiale. 1.17 Agjent Biologjik do të thotë cdo mikroorganizëm/a patogjenik (që prodhon sëmundje) apo helme biologjike të prodhuara (përfshirë organizmat e modifikuar gjenetikisht apo helmet kimike sintetike) që shkaktojnë sëmundje dhe/ose humbje e jetës në qëniet njerëzore, kafshët apo bimët. 1.18 Certifikata e Sigurimit certifikata e lëshuar nga siguruesi ose ndërmjetësi i autorizuar nga Siguruesi, subjekt i kushteve të policës në grup, mbi bazën e detajeve të dakordësuarra, e cila i lëshohet klientit huamarrës, si evidencë e pranimit të rrezikut, dhe përmban minimalisht të dhënat identifikuese të të siguruarit, afatin e fillimit dhe përfundimit të mbulimit, kushtet e përgjithshme të sigurimit dhe detaje të tjera të nevojshme sipas përcaktimeve të siguruesit. 1.19 Afati i policës i referohet afatit të Policës së sigurimit në grup, brenda të cilit janë lëshuar certifikatat e sigurimit për individët e siguruar të grupit (klientët e Policëmbajtësit). Gjithashtu referencat me afatin e policës nënkuptojnë dhe afatin e mbulimit të certifikatave të sigurimit. 1.20 Data e fillimit të rrezikut data e fillimit të mbulimit për të siguruarin, e cila do të nënkuptojë datën e fillimit të mbulimit sipas certifikatës, nëse kjo e fundit është lëshuar brenda periudhës së mbulimit të policës së sigurimit në grup. 1.21 Lista e të siguruarve është një regjistër i mbajtur nga Policëmbajtësi, i cili përmban informacione rreth të siguruarve, duke përfshirë por pa u kufizuar në numrin unik të certifikatës, datën e lëshimit, të dhënat personale, vlerën e huasë, monedhën që lëshohet certifikata, primin total, datën e fillimit dhe datën e mbarimit. 1.22 Policëmbajtësi nënkupton personin apo subjektin i cili është emëruar në policë. 1.23 Data e fillimit të policës data kur kjo policë sigurimi fillon efektet/hyn në fuqi, sipas afatit në skedulin e policës. 1.24 Data e lëshimit të policës nënkupton datën e lëshimit të policës në grup nga shoqëria e sigurimit. 1.25. Data e rinovimit të policës nënkupton të njëjtën datë në fund të çdo viti nga data e lëshimit të policës në grup.

2. Detyrimet e Siguruesit

2.1 Detyrimet e Siguruesit linden kur Polica e Sigurimit hyn në fuqi sipas pikës nr. 6 të kushteve të sigurimit.

3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit

3.1 Siguruesi ka detyrim profesional për ruajtjen e sekretit në lidhje me informacionin e marrë konform statusit të siguruesit përveç rasteve kur dhënia një informacioni të tillë përbën detyrim ligjor. 3.2 Siguruesi ka detyrim ligjor për ruajtjen e sekretit në lidhje me informacionin e marrë konform statusit të siguruesit, si dhe administrimi i të dhënave, përpunimi dhe transferimi edhe ndërkombëtar i të dhënave sensitive tek partnerët, risiguruesi, kryhet vetëm pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe vetëm për qëllime të kontratës së sigurimit, risigurimit dhe të asistencës nëpërmjet një agjencie ndërkombëtare, për efekt të trajtimit të sigurimit, dhe në respekt të përcaktimeve të ligjit në fuqi "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", 9887, datë 10.03.2008 (i ndryshuar), si dhe legjislacionit në fuqi.

4. Debitorët e siguruar dhe të siguruarit

4.1 Debitori apo të Siguruarit do të quhen të siguruar kur Polica e Sigurimit hyn në fuqi. 4.2 Debitori apo të Siguruarit janë përgjegjës, dorëzanës apo garantojnë shlyerjen e Huasë ndaj Kreditorit. 4.3 Në këtë kontratë sigurimi do të përfshihen të siguruarit që janë në kufijtë 18 deri në 65 vjeç. Si rregull, sigurimi mbetet në fuqi deri në moshën 70 vjeç për kredimarrësit, të cilët gjatë periudhës së sigurimit arrijnë këtë moshë. Në marrëveshje me Kreditorin, rast pas rasti mund të bëhet përjashtim nga rregulli i mësipërm kur në policë shtohet një i siguruar i dytë, i cili do të jetë nën moshën kufi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së sigurimit.

5. Njoftimet e të siguruarit dhe kreditorit

5.1 Deklarimet e të Siguruarit dhe Kreditorit duhet të jenë të sakta dhe të plota. 5.2 Kreditori duhet ti ofrojë Siguruesit çdo informacion që ka lidhje me debitorët apo personat e siguruar. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit Kreditori duhet ti lejojë Siguruesit të inspektojë çdo material që ka lidhje me të Siguruarin. 5.3 Nëse pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i Siguruarit ka bërë deklarime të pasakta apo ka mbajtur të fshehtë informacione të tilla, për të cilat Siguruesi nuk do të kishte dhënë pëlqimin për të lëshuar Policën e Sigurimit ose nuk do ta kishte lëshuar me të njëjtat kushte nëse do të dinte gjëndjen e vërtetë të fakteve, Siguruesit i lind drejta: a) Në rast se deklarimet e pasakta janë bërë me dashje apo i Siguruarit ka qënë në dijeni të informacioneve të cilat i ka mbajtur të fshehta: 5.3.1 Të zgjidhë kontratën e sigurimit në çdo kohë duke filluar nga data që njihet me deklarimet e pasakta apo fshehjen e fakteve. 5.3.2 Të refuzojë pagesat në rast se vërtetohet ngjarja e sigurimit në çdo kohë. b. Në rast se deklarimet e pasakta janë bërë pa dashje: 5.3.3 Të tërhiqet nga kontrata në çdo kohë duke filluar nga data që u njoh me deklarimet e pasakta ose fshehjen e fakteve. 5.3.4 Të reduktojë në rast dëmi dhe në çdo kohë shumën e sigurimit nëse është vërtetuar një risk më i lartë për të cilin Debitori apo i Siguruarit duhet të paguajë një prim më të lartë. 5.3.5 Të refuzojë në rast dëmi dhe

në çdo kohë, pagesën e përfitimit nëse Siguruesi nuk do ta kishte nënshkruar kontratën po të ishte në dijeni të gjëndjes së vërtetë të fakteve. 5.4 Deklarimi i pasaktë i moshës së të siguruarit çon në ndryshimin e shumës së sigurimit në bazë të moshës reale të të Siguararit. 5.5 Në rast se vërtetohen ndryshime të profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit të një natyre të tillë që po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, Siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë dhe njëkohësisht Siguruesi nuk ka marrë një njoftim me shkrim në lidhje me këtë ndryshim, shumën e sigurimit do të reduktohet sipas koeficientit që del si raport i çmimit të ulur, i cili është përcaktuar në fillim të kontratës me çmimin real që duhet të paguante i Siguarari sikur të ndryshonte profesionin apo veprimtarinë e tij.

6. Hyrja në fuqi e sigurimit

6.1 Polica e Sigurimit do të lëshohet për të gjithë shumën e Sigurimit. Sigurimi për pjesën e përgjegjësive që ALBSIG Jeta Sh.a. merr përsipër të mbulojë deri në marrjen e konfirmimit përfundimtar nga Risiguruesi, hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përcaktuar në Policën e Sigurimit dhe që konsiderohet si datë e lëvrimit të huasë, me kusht që: 6.1.1 Të jetë nënshkruar nga debitori Polica e Sigurimit te Jetës për Hua; 6.1.2 Siguruesi ka lëshuar policën e sigurimit apo ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij; 6.1.3 Të jetë arkëtuar primi ose kësti i parë i primit të sigurimit; 6.2 Në qoftë se Polica e Sigurimit parashikon një datë të mëvonshme të fillimit të saj, sigurimi nuk mund të hyjë në fuqi përpara orës 24.00 të ditës së caktuar.

7. Rreziku i humbjes së jetës

7.1. Rreziku i humbjes së jetës është i mbuluar pa asnjë kufizim territorial.

8. Përfitimi i dëmshërblimit

8.1 Në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit përpara përfundimit të Policës së Sigurimit, Siguruesi detyrohet ti paguajë Përfituesit (Kreditorit) përfitimin për Sigurimin e Jetës deri në shumën e papaguar të huasë sipas parashikimeve të policës, por në çdo rast jo më shumë se shumën e siguruar. 8.2 Në rastin e disa Debitorëve apo të Siguararve (maksimumi 2) të siguruar nën të njëjtën Policë Sigurimi, për të njëjtën Shumë sigurimi, shumën e dëshpërblimit do ti paguhet Përfituesit vetëm me humbjen e jetës e Debitorit të siguruar dhe të Siguararit të fundit.

9. Kalimi i të drejtës (subrogimi)

9.1 PAGESA E PËRFITIMIT DO TË JETË NË VARËSI TË KALIMIT TEK ALBSIG JETA I TË GJITHA TË DREJTAVE TË POLICËMBAJTËSIT/PËRFITUESIT/TË SIGUARARIT NDAJ ÇDO PALE TË TRETË PËRGJEGJËSE PËR NGJARJEN E SIGURIMIT, DHE ASNJË PERSON OSE AUTORITET NUK DO TË VEPROJË PËR TË PARAGJYKUR KËTO TË DREJTA. 9.2 ÇDO KËRKUES PAGESE SIPAS KËSAJ POLICE, ME KËRKESËN E ALBSIG JETË, DO TË NDËRMARRË DHE DO TË LEJOJË TË NDËRMERREN TË GJITHA MASAT E NEVOJSHME PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE NDAJ ÇDO PALE TË TRETË NË EMËR TË TË SIGUARARIT PARA DHE/OSE PAS ÇDO PAGESE TË KRYER NGA ALBSIG JETË.

10. Përrjashtime

10.1. Për efekte të kësaj kontrate do të konsiderohen rreziqe të përrjashtuara dhe Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës të të Siguararit në rast se humbja e jetës vjen si pasojë direkte apo indirekte e: 10.1.1 Çdo lloj defekti fizik apo mendor paraekzistues, sëmundjeve të njohura, të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguarari dhe është pranuar nga Siguruesi. 10.1.2 Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes, akteve terroriste të lidhura me terrorizmin berthamor, kimik dhe biologjik; 10.1.3 Akte të qëllimshme të kryera nga përfituesi direkt kundër interesave të të siguruarit; 10.1.4 Reaksioneve bërthamore, rrezatimit bërthamor; 10.1.5 Pasojat e infektimit me virusin HIV, respektivisht SIDA, (Sindromi i Deficiencës Imunitare të Fituar); 10.1.6 Vetëvrasjes; 10.1.7 Pjesëmarrjes së të siguruarit në kryerjen e një krimi; 10.1.8 Udhëtimit të të Siguararit me çdo mjet fluturimi, përveç se kur udhëton si pasagjer (dhe jo si anëtar i ekuipazhit), në një mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjerëve; 10.1.9 Sporteve të rrezikshme si sporteve motorike, zhytjes, alpinizmit të çdo lloji, hedhje e lirë nga lartësi me ose pa motor, parashutizmi, artet marciale, kanotazhi i çdo lloji, hedhjes nga lartësi të mëdha duke qënë i lidhur; 10.1.10 Pjesëmarrjes në gara shpejtësie të çdo lloji; 10.1.11 Përfshirjes së të Siguararit në veprimtari të paligjshme apo kriminale, akte kriminale e keqëdashëse nga persona me të cilët i Siguarari ka konflikte të mëparshme, ose kur sigurimi kryhet në rrethana të paramenduara që favorizojnë pagesën e dëmit; 10.1.12 Humbjes së jetës së të siguruarit si pasojë e veprimeve të qëllimshme të trashëgimtarëve ligjore, apo ortakëve; 10.1.13 Humbjen e jetës si pasojë e ndodhjes së të siguruarit nën influencën e alkoolit, përdorimit të drogës ose intoksikantëve të çdo lloji; 10.1.14 Në rast të humbjes së jetës, përfituesi nuk do të paguhet në rast se kufoma nuk gjëndet apo është e paidentifikueshme; 10.2.0 Në rastet e disa Debitorëve apo të Siguararve nën të njëjtën policë sigurimi, për të njëjtën hua, Siguruesi nuk është i detyruar të kthejë primet e sigurimit, nëse vërtetohet humbja e jetës e njërit debitor apo të siguruar për një nga shkaqet e mësipërme, pasi polica e sigurimit do të mbetet në fuqi për bashkë-debitorët apo persona të tjerë të siguruar që mbeten gjallë.

11. Persona që nuk sigurohen

Siguruesi nuk ofron sigurimin për: a) Personat që vuajnë nga alkolizmi, narkotizmi ose sëmundje mendore si skicofrenia, format maniako – depresive të gjendjes paranoiake apo sindromat organike – celebrale; b) Personat që kërkojnë kujdes të përhershëm; c) Personat mbi moshën 65 vjeç.; d) Personat nën moshën 18 vjeç.

12. PAGESA E PRIMEVE

12.1 PAGESA E PRIMEVE DO TË BËHET NË VARËSI TË KOHËZGJATJES SË HUASË NË DISA PERIUDHA. PRIMI I PARË I SIGURIMIT DO TË PAGUHET NË DATËN E LËVRIMIT TË HUASË. TË GJITHË KËSTET VIJUESË PËR VITET NË VAZHDM JANË TË PAGUESHME BRËNDA PERIUDHAVE KOHORE PREJ 15 DITËSH NGA DATA E KËSTIT VIJUESË TË PRIMIT. 12.2 PRIMET E SIGURIMIT DUHET TË ARKËTOHEN PRANË ZYRAVE TË SIGURUESIT APO NËPËRMJET SISTEMIT BANKAR NË LLOGARINË E SIGURUESIT; 12.3 NËSE KREDITORI APROVON SHTYRJEN E AFATIT PËR KTHIMIN E HUASË, I SIGUARARI DUHET TË PAGUJËJË NJË PRIM SHITESË SIPAS AFATIT TË RI. 12.4 KËSTET VJETORE NË VIJIM, PAS PAGESËS SË KËSTIT TË PARË, MUND TË RILLOGARITEN NGA SIGURUESI.

13. Mospagimi i primeve

13.1 Mospagimi i kësteve vijuese të primit sipas afateve të caktuara në pikën 12.1, sjell pezullimin e sigurimit nga ora 24.00 të ditës së 15 kalendarike pas mbarimit të afatit të pagesës së primit; 13.2 Pas kalimit të afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditor, siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe primet e paguara i mbeten Siguruesit; 13.3 I Siguarari nuk çlirohet nga detyrimi për pagesën e primit edhe në ato raste kur pretendon se Siguruesi nuk e ka njoftuar për datat e përfundimit të sigurimit;

14. Riaktivizimi i kontratës së sigurimit

14.1 Brënda 6 muajve nga skadimi i mospagesës së kështit të primit të parë ose kështit vijues të primit, policëmbajtësi dhe/ose i Siguarari ka të drejtë të riaktivizojë sigurimin dhe Siguruesi ka të drejtë të kërkojë pagesën e primeve dhe një deklaram që gjendja shëndetësore e të Siguararit nuk ka ndryshuar; 14.2 Pas kalimit të 6 muajve nga data e skadencës, riaktivizimi, mund të bëhet vetëm me kërkesën e policëmbajtësit dhe/ose të të Siguararit dhe pranimin me shkrim të Siguruesit, i cili mund të kërkojë edhe vërtetime të reja të gjëndjes shëndetësore dhe të vendosi pastaj për riaktivizimin e sigurimit; 14.3 Në çdo rast riaktivizimi, sigurimi hyn në fuqi për të gjithë vlerën e tij, në orën 24.00 të datës së pagimit të shumës së duhur të primit; 14.4 Pas kalimit të 24 muajve nga skadencia e mospagimit të kështit të parë të primit, sigurimi nuk mund të riaktivizohet;

15. Përfundimi i kontratës së sigurimit Kontrata e Sigurimit do të konsiderohet e përfunduar në rast të:

15.1 Përfundimit të periudhës së huasë; 15.2 Rikthimit të plotë të shumës së huasë; 15.3 Transferohet huaja tek një individ/subjekt tjetër jo i përfshirë në këtë Policë Sigurimi 15.4 I siguruari arrin moshën 70 vjeç; 15.5 Ka ndodhur ngjarja e sigurimit, ose Siguruesi i ka paguar Kreditorit shumën e dëmshpërblimit;

16. Cedimi pengu dhe bllokimi

16.1 I Siguruari nuk mund ta çdojë Policën e Sigurimit të një palë e tretë si garanci, ose nuk mund ta bllokojë shumën e sigurimit në emër të një personi të tretë.

17. Lëshimi i dublikatës

17.1 Nëse policia origjinale priset, griset ose bëhet e pavlefshme, i Siguruari me shpenzimet e tij duhet të pajset me një policë të re sigurimi.

18. Afatet e Njoftimit

18.1 Me ndodhjen e rastit të sigurimit Përfituesi/apo i Siguruari janë të detyruar të njoftojnë Siguruesin, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, pasojat e saj si dhe të respektojnë porositë dhe kërkesat e Siguruesit. 18.2 Njoftimi i Siguruesit duhet të bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ndodhja e rastit të sigurimit ose në pamundësi objektive, jo më vonë se 3 (tre) muaj.

19. Pagesat e siguruesit

19.1 Për të gjitha pagesat që Siguruesi do të bëjë duhet të dorëzohen paraprakisht dokumentet e mëposhtme: 19.1.1 Njoftimin e rastit të Sigurimit; 19.1.2 Polica origjinale e Sigurimit; 19.1.3 Çertifikatë e lindjes së të siguruarit; 19.1.4 Çertifikatë e humbjes së jetës të siguruarit; 19.1.5 Skeda e humbjes së jetës e firmosur nga mjeku ligjor; 19.1.6 Raporti mjeko - ligjor për datën e ndodhjes, rrethanat, dhe shkakun e humbjes së jetës; 19.1.7 Epikrizë mjekësore e lëshuar nga mjeku kurues ku përshkruhet qartë data e shtrimit në spital, diagnoza klinike, mjekimet e kryera si dhe shkakun e humbjes së jetës; 19.1.8 Dokumentet që vërtetojnë shumën e dëmshpërblimit që Siguruesi detyrohet të paguajë (përfshirë shumën e huasë së papaguar) sipas pikës 1.10; 19.1.9 Kopje e Kontratës së Kredisë me gjithë ndryshimet që mund ti jenë bërë nga Përfituesi si dhe një grafik të shlyerjeve të kredisë që ka realizuar Debitori; 19.1.10 Çdo dokument tjetër që mund të kërkohej nga Siguruesi. 19.2 Siguruesi detyrohet të paguajë dëmshpërblim brënda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së dokumentacionit të plotë; 19.3 Pagesat do të bëhen në llogarinë e Kreditorit, nëse huaja është lëvruar. Nëse për ndonjë arsye nuk është realizuar lëvrimi i huasë, detyrimi i Siguruesit është vetëm kthimi i primit të sigurimit.

20. Taksat dhe Tatimet

20.1 Taksat dhe Tatimet, nëse do të ekzistojnë do të jenë në ngarkim të të Siguruarit dhe Kreditorit.

21. Dispozita të tjera

21.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë për sa është parashikuar në këtë kontratë kur nuk zgjidhen me mirëkuptim do të zgjidhen me rrugë Gjyqësore. 21.2 Për çdo gjë që nuk është e parashikuar në dispozitat e këtyre kushteve të përgjithshme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

KUSHTET SHITESË PËR SIGURIMIN NGA AKSIDENTET (SIGURIM SHITESË I SIGURIMIT TË JETËS)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti 1. Këto kushte për sigurimin nga aksidentet si mbulim shtesë (këtu e mëposhtë do të quhen "Kushte Shtesë") dhe janë pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit të jetës (këtu e mëposhtë do të quhet "Kontrata") që kontraktuesi/i siguruari ka nënshkruar me shoqërinë ALBSIG JETË (këtu e mëposhtë do të quhet "Sigurues"). 2. Sipas këtyre kushteve Shtesë mund të kontraktohet sigurim për rastet e: a. paaftësisë së përhershme, të plotë që rezulton nga aksidenti, sipas nenit 2 mëposhtë në këto Kushte Shtesë:

Neni 2 Përcaktime "Dëm trupor" do të konsiderohet dëmtimi fizik i identifikueshëm që: a. shkaktohet nga një Aksident; b. shkakton paaftësinë e të Siguruarit brenda dymbëdhjetë muajsh nga data e Aksidentit, i vetëm dhe në mënyrë të pavarur nga çdo shkak tjetër. "Aksident" do të konsiderohet një ngjarje e menjëhershme, e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa qëllimin e të Siguruarit, që ka impakt të jashtëm direkt dhe të dhunshëm në trupin e tij dhe që rezulton në humbje të jetës ose në paaftësinë e përhershme brenda 12 muajsh nga data e ndodhjes. Si aksidente konsiderohen edhe rastet e poshtëshënuara: a. Helmimi me ushqim ose me lëndë kimike për shkak të mosinformimit të të siguruarit, përveç sëmundjeve profesionale. b. Infeksioni i plagëve të shkaktuara nga Aksidenti. c. Helmimi për shkak të thithjes së gazrave ose avujve helmues, përveç sëmundjeve profesionale. d. Djegia nga zjarri ose energjia elektrike, objekte të nxehtë, lëngje ose avuj, acide, baza ose të ngjashme. e. Mbytja ose fundosja në ujë. f. Mbytja nga marrja e frymës për shkak të mbulimit (me dhera, rërë, dhe të ngjashme). g. Tërheqja e muskujve, përdredhja, hollimi, thyerja e kockave që ndodhin për shkak të lëvizjeve të vullshme të trupit ose tensionimeve (sforcimeve) të padëshiruara të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara të jashtme, nëse pas plagosjes kjo është përcaktuar (vërtetuar) në spital. h. Efektet (veprimet) e dritës, rrezeve të diellit, temperaturës ose kohës së keqe, nëse i siguruari ka qenë direkt i ekspozuar ndaj tyre për shkak aksidenti, i cili ka ndodhur para kësaj ose është gjendur në rrethana të tilla të paparashikuara, të cilat nuk ka mundur t'i ndalojë (shmangë) ose është ekspozuar ndaj tyre për shkak të shpëtimit të jetës së njeriut. i. Efektet (veprimet) e rrezeve rëntgen ose radium, nëse ndodhin papritur ose në mënyrë të paparashikuar, përveç sëmundjeve profesionale. j. Vitium artis, pasojat nga ndërhyrjet mjekësore veçanërisht kirurgjikale, të ndërmarra për të kuruar ose parandaluar një sëmundje, kur këto kanë ndodhur për shkak të gabimit të vërtetuar (provuar) të personelit mjekësor.

"Paaftësi e Plotë e Përhershme" do të konsiderohet paaftësia që e ndalon të Siguruarin tërësisht nga kryerja e çdo veprimtarie ekonomike ose pune të çdo lloji, që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe që në përfundim të periudhës së sigurimit është pa shpresë për mirësim.

Neni 3 Përcaktimi i aksidentit Nuk do të konsiderohen aksidente: a. Sëmundjet ngjitëse, profesionale dhe të ngjashme si dhe pasojat nga sëmundjet psikike. b. Herniet e barkut, umbilikale (të kërthizës), herniet murore ose të tjera. c. Herniet, të cilat shkaktohen nga dëmtimi direkt i murit të barkut nën veprimin direkt të ndonjë force mekanike të jashtme mbi murin e barkut, nëse pas dëmtimit është përcaktuar hernie traumatike tek e cila klinikisht përveç hernies është përcaktuar (vërtetuar) dëmtimi i pjesëve të buta të murit të barkut në atë zonë do të njihen si aksident. c. Infeksionet dhe sëmundjet, të cilat ndodhin për shkak të alergjive të ndryshme, prerjes ose shkuljes së akneve, naevus ose gungave të tjera në lëkurë të shëndoshë. d. Shoku anafilatik, përveçse nëse ndodh gjatë kurimit për shkak aksidenti. e. Herniet diskale intervertebrale, të gjitha llojet e lumbagos, diskopatisë, sakralgjisë, miofascitis, koksartrozës, gonartrozës, iskialgjisë, fibrozitis, fascitis dhe të gjitha ndryshimet patoanatomike të pjesës së ijeve dhe legenit, me terma analoge. f. Shkollitja e retinës (ablation retinae) tek një sy paraprakisht i sëmurë ose degjenerativ. f. Shkollitja e retinës të syrit paraprakisht të shëndoshë, nëse ekzistojnë shenja të dëmtimit të jashtëm të drejtpërdrejtë të kokërdhokut të syrit, të konstatuara nga institucionet shëndetësore do të njihet si aksident. g. Pasojat që shkaktohen nga delirium tremens ose ndikimi i drogave. h. Pasojat nga ndërhyrjet mjekësore veçanërisht kirurgjikale, të cilat ndërmerren për kurimin ose

parandalimin e sëmundjes, përveçse kur këto pasoja kanë ndodhur në mënyrën e përshkruar në Nenin 2 pika (j) . i. Ndryshimet patologjike të kockave dhe epifiziologji patologje. j. Sëmundjet sistematike neuromuskulare dhe sëmundje endokrine.

FILLIMI DHE PERIUDHA E SIGURIMIT

Neni 4 Produkti i sigurimit 1. Sigurimi nga Aksidentet si sigurim shtesë i sigurimit të jetës sipas këtyre kushteve Shtesë fillon në orën 00.00 të ditës, e cila është përcaktuar në policë si dita fillimit të sigurimit të jetës, nëse deri në atë ditë është paguar primi shtesë (nëse është rasti) bazuar në procedurën e vlerësimit të riskut të kryer nga Siguruesi.

Detyrimi i siguruesit sipas këtyre kushteve Shtesë ndërpritet: a. Në orën 00.00 të ditës së përcaktuar në policë si ditë e përfundimit të kontratës së sigurimit. b. Kur ndërpritet sigurimi i jetës sipas polices, në bazë të së cilës është lidhur ky sigurim plotësues.

Si periudhë sigurimi sipas këtyre kushteve Shtesë konsiderohet periudha kohore e shënuar në policë.

DETYRIMI I SIGURUESIT

Neni 5 Përfitimi i pagueshëm 1. Kur ndodh aksident sipas këtyre kushteve Shtesë, siguruesi ka si detyrim të paguajë të gjithë vlerën e shumës së sigurimit të përcaktuar në Policë si shumë e siguruar për Aksidentet (sigurim shtesë) në rast se si rezultat i aksidentit rezulton paaftësi e përhershme e plotë (100%) e të siguruarit.

KUFIZIME TË DETYRIMEVE TË SIGURUESIT

Neni 6 Zvogëlimi i shumës së sigurimit si rrjedhojë e mospagesës së primit shtesë 1. Nëse nuk është paguar primi shtesë përkatës, shuma e sigurimit zvogëlohet në përpjestim ndërmjet primit që do të paguiej dhe primit të paguar për aksidentet e mëposhtme: a. Gjatë drejtimit dhe pilotimit të avionëve dhe mjeteve fluturuese të të gjitha llojeve, si dhe gjatë hedhjeve sportive me parashutë. b. Gjatë veprimtarive çlodhëse të çdo lloji, trajnimit ose pjesëmarrjes së të siguruarit në takime sportive publike në cilësinë e anëtarit të regjistruar të shoqërive sportive amatore ose profesioniste dhe kjo për sportet e mëposhtme: (çiklizëm, kërcim nga struktura të larta duke qenë i lidhur me litar elastik (bungee jumping), futboll, hokej, voleyboll, xhudo, karate, si dhe çdo lloj tjetër arti marcial, boks, kikboks, ski, regbi, mundje, patinim me patina, paragliding (fluturim me parashutë), fluturime me deltaplan, rafting, lundrim me kajakë, basketboll, rrëshqitje me slitë, kërcime me ski, alpinizëm, gjueti nënujore e peshkut si dhe gjatë garave automobilistike me motorcikël, motornautika dhe gokart, motokros, si dhe gjatë trajnimit për këto sporte dhe gjatë veprimtarive speleologjike) c. Si rrjedhojë e veprimeve dhe konflikteve luftarake të cilitdo lloji jashtë kufijve të Shqipërisë, përveçse nëse aksidenti ka ndodhur brenda 14 ditëve nga fillimi i këtyre ngjarjeve në vendin në të cilin qëndron i siguruari dhe nëse këto ngjarje e kanë bllokuar aty, me kusht që i siguruari të mos ketë marrë pjesë në këto ngjarje dhe konflikte. d. Si dhe për aksidente të tjera që rrjedhin si pasojë e ushtrimit të profesioneve, aktiviteteve të kohës së lirë apo sporteve të ushtruara si profesionist, për të cilat nga procedura e vlerësimit të riskut rezulton që duhet të paguhet prim shtesë.

PËRJASHTIME TË DETYRIMEVE TË SIGURUESIT

Neni 7 Detyrime të përjashtuara për siguruesin 1. Janë të përjashtuara plotësisht të gjitha detyrimet e siguruesit, nëse aksidenti ka ndodhur: a. Për shkak lufte, ose ngjarjeje luftarake, armiqësi ose veprimtari të ngjashme me luftën, luftë civile, revolucion, kryengritje ose demonstratat qytetare të cilat rrjedhin nga ngjarje të tilla. b. Për shkak sabotimi ose terrorizimi të kryer nga trazira politike, ushtrim dhune ose ngjarje të tjera. c. Gjatë drejtimit të mjeteve fluturuese të të gjitha llojeve, mjeteve lundruese, mjeteve motorike ose të tjera pa lejen përkatëse të drejtimit, e cila drejtuesit të mjetit i jep autorizim për drejtime të atij tipi mjeti fluturues, mjeti lundrues, mjeti motorik ose mjet tjetër. d. Për shkak të tentativës së kryerjes së vetëvrasjes nga i siguruari, i qëllimtë nga i siguruari ose përfituesi. e. Gjatë përgatitjes, tentativës ose kryerjes së një veprimi të dënueshëm me paramendim si edhe gjatë arratisjes pas një veprimi të tillë. f. Si pasojë e konsumit nga i Siguruari të alkoolit, drogave të çdo lloji.

PAGESA E PRIMIT

Neni 8 Pagesa e primit Primi sipas këtyre kushteve Shtesë paguhet bashkë me primin për sigurimin e jetës.

NJOFTIMI I AKSIDENTIT

Neni 9 Njoftimi i ngjarjes së sigurimit 1. Kontraktuesi, i siguruari ose përfituesi është i detyruar të njoftojë siguruesin për aksidentin brenda 7 ditësh nga dita e ndodhjes. 2. I siguruari është i detyruar: a. të paraqitet menjëherë te mjeku, ose të thërrasë mjek për kontroll dhe dhënie të ndihmës së nevojshme dhe të ndërmarrë menjëherë të gjitha masat e nevojshme për kurim, si dhe të respektojë (zbatojë) këshillat dhe udhëzimet e mjekut për mënyrën e kurimit; b. t'i japë siguruesit të gjitha të dhënat për vendin dhe kohën kur ka ndodhur aksidenti, me përshkrim të plotë të ngjarjes, emrin e mjekut, i cili e ka kontrolluar (vizituar) dhe e ka udhëzuar për kurim dhe emrin e mjekut, i cili e kuron; c. të paraqesë përshkrimin (diagnozën) e mjekut për llojin dhe masën e dëmtimit trupor, për pasojat eventuale të ndodhura, si dhe të dhëna për të metat trupore, mangësitë dhe sëmundjet që i siguruari kishte para ndodhjes së aksidentit; d. në rast të qëndrimit të të siguruarit në spital për kurim nga pasojat e aksidentit apo në rast trajtimi mjekësor ambulator në shtëpi, t'i dorëzojë siguruesit fletë daljen e spitalit, historikun e sëmundjes, rekomandimet e mjekut, raportet për paaftësi të përkohshme në punë dhe dokumentat e tjerë mjekësorë që do t'i kërkojë siguruesi; e. nëse aksidenti ka patur pasojë humbjen e jetes e të siguruarit, përfituesi i sigurimit është i detyruar të njoftojë siguruesin dhe të grumbullojë dokumentacionin e nevojshëm mjekësor dhe dokumenta të tjera. 3. Shpenzimet për kontrollin mjekësor dhe raportet, si dhe shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me sqarimin e rrethanave të ndodhjes së aksidentit dhe të drejtat nga kontrata e sigurimit janë në ngarkim të paraqitësit të kërkesës. 4. Siguruesi është i autorizuar dhe ka të drejtë që të kërkojë nga i siguruari, kontraktuesi, përfituesi, institucion shëndetësor ose nga cilido person fizik ose juridik shpjegime ose prova, dhe me shpenzimet e tij të kërkojë kontroll mjekësor të të siguruarit nëpërmjet komisioneve të tij mjekësore për përcaktimin e të dhënave të vlefshme në lidhje me aksidentin e paraqitur. 5. Nëse i siguruari nuk vepron sipas parashikimeve të pikës 2 paragrafi (a) të këtij neni dhe nëse për këtë shkak sjell si pasojë ndodhjen e invaliditetit ose që invaliditeti të jetë më i madh nga sa mund të ishte, ka të drejtë vetëm për dëmshpëblim të zvogëluar përpjestimor. 6. Kontraktuesi, i siguruari ose përfituesi ne parim mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë njoftuar aksidentin me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të këtyre kushteve Shtesë.

PAGESA E PËRFITIMIT

Neni 10 Pagesa e përfitimit të pagueshëm 1. Siguruesi paguan përfitimin brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur është përcaktuar vlera e detyrimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të fundit të kërkuar nga Siguruesi. 2. Siguruesi paguan përfitim për paaftësinë që rezulton nga aksidenti vetëm nëse aksidenti ka ndodhur brenda periudhës së vlefshmërisë së sigurimit dhe nëse pasojat e aksidentit të parashikuara në nenin 5, të këtyre kushteve Shtesë janë shfaqur brenda një viti nga dita e ndodhjes së aksidentit. 3. Vlera e përfitimit të llogaritur për shkak të paaftësisë së plotë të përhershme është e përfshirë në vlerën e përfitimit për jetën.

PROÇEDURA E EKSPERTIZËS

Neni 11 Ekspertiza 1. Në çdo rast, kur kontraktuesi, i siguruari ose përfituesi i sigurimit nuk janë dakord në lidhje me mënyrën, shkaku ose

pasojat e aksidentit, si dhe në lidhje me masën e detyrimit të siguruesit, përcaktimi i fakteve të kundërshtueshme do t'i besohet ekspertëve nga specialistet të caktuara, në përputhje me mosmarrëveshjen përkatëse. 2. Në rastin e paragrafit (1) të këtij neni, një ekspert emërohet (zgjidhet) nga siguruesi, kurse i dyti nga pala tjetër. Nëse konstatimet e tyre nuk përputhen, ekspertët e emëruar caktojnë ekspert të tretë, i cili mendimin e tij të specializuar do t'a japë vetëm në lidhje me ato fakte të cilat janë të kontestueshme ndërmjet tyre dhe në kufijtë e konstatimeve dhe mendimeve të tyre. Secila palë paguan shpenzimet e ekspertëve, të cilët ka emëruar, ndërsa për ekspertin e tretë secila palë paguan gjysmën e shpenzimeve.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12 Dispozita Përfundimtare 1.Për marrëdhëniet ndërmjet palëve kontraktuese, të cilat nuk janë rregulluar me këto kushte Shtesë, zbatohet Kodi Civil. 2. Siguruesi në kuadër të kësaj kontrate mbledh, ruan depoziton dhe përdor të dhënat personale të nevojshme për nënshkrimin e policës së sigurimit, në respektim të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.

Kushtet e Përgjithshme për Humbjen e Jetes Aksidentale dhe Paaftësinë e Përkohshme për të Punuar për Sigurimin e Mbrojtjes së Kredisë

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë mbulon detyrimet tuaja të shlyerjes së kredisë ndaj luteCredit Albania, ne vijim referuar si "luteCredit" për një ngjarje të mbuluar nga polica e sigurimit për seksionin përkatës.

Ju keni aplikuar për Sigurimin e Mbrojtjes së Kredisë dhe pas marrjes dhe pranimit të primit të sigurimit, ky sigurim do t'ju sigurojë mbulimin që keni përzgjedhur siç është përshkruar në Certifikatën Tuaj të Sigurimit.

Kriteret e pranimit

Ju keni të drejtë mbulimi sipas këtij seksionisigurimi nëse në datën e fillimit:

Ju po e merrni këtë Policë për të siguruar Pagesat e Kredisë në një Marrëdhënie Kredie me luteCredit në emrin tuaj (duke përjashtuar marrëveshjet e hipotekore); dhe

Ju jeni rezident i përhershëm në Republikën e Shqipërisë; dhe

Mosha juaj është midis 18 dhe 64 vjeç në datën e fillimit; dhe

Ju jeni duke punuar në mënyrë aktive gjatë datës së fillimit dhe kur dëmi juaj ndodh, për jo më pak se 16 orë çdo javë; dhe

Ju keni qenë vazhdimisht i punësuar për të paktën 6 muaj menjëherë para datës së fillimit të kësaj Policë; ose keni pasur aktivitetin tuaj të vazhdueshëm të biznesit për të paktën 12 muaj menjëherë para datës së fillimit; dhe

Vendi juaj i punës është brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe

Ju pranoni t'i përmbaheni termave dhe kushteve të kësaj Police.

Ju nuk mund të mbuloheni nën këtë sigurim nëse në datën e fillimit:

Ju nuk rezultoni si kredimarrës në Kontraten e kredisë me luteCredit;

Ju jeni në dijeni të ndonjë sëmundjeje të afërt;

Ju jeni në punë rastësore, të përkohshme ose sezonale,

Ju jeni në dijeni të papunësisë së afërt ose pensionit që do të ndodhe gjatë periudhës së mbulimit.

Kushte të përgjithshme

Disa nga fjalët dhe frazat që përdorim në këtë Policë kanë kuptime të veçanta dhe këto tregohen më poshtë me kuptimet e tyre në krah.

